



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit

09/Nr. ____/22

10345

KONTRATË PËR PUNË SHITESË
“Rregullimi i parkut ne rr.Isa Berisha Hani i Elezit”

Lidhur me datë 22.12.2022 ne mes te Komunës Hani i Elezit dhe shpk. “Murseli Company” nga Kaçaniku për kontratën për “Punë shtesë - Rregullimi i parkut ne rr.Isa Berisha Hani i Elezit” me nr.prok.KKHE-019/2022-521, me nr.te platformes se e-prokurimit 659-22-14385-5-3-5

I

Duke u bazuar në Kontratën e lidhur me datë 22.07.2022 në mes të Komunës Hani i Elezit dhe shpk. “Murseli Company” nga Kacaniku per projektin “Punë Shtesë - Rregullimi i parkut ne rr.Isa Berisha Hani i Elezit” me nr.prok. KKHE-019/2022-521.

II

Do te punohet puna shtese konform paramases se propozuar nga komisioni mbikqyrës – menaxheri i kontrates dhe aprovuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ sipas kërkesës së drejtorisë përkatëse – Drejtoria e Urbanizmit .

III

Vlera e kesaj aneks-kontrate eshte 9,998.90 € (Nëntë mijë e Nëntëqind e Nëntëdhjetë e Tetë euro/90 cent), konform paramasës për punë shtesë apo 4.10 % e vleres se kontrates bazë (243,936.04 €).

IV

Vlefshmëria e aneks kontratës fillon prej datës 22.12.2022 dhe zgjatë deri në përfundim të punës (10 dite). Punimet mund të fillojnë më së voni 1 ditë nga data e nënshkrimit të kësaj aneks-kontrate.

V

Sigurimi i ekzekutimit eshte 10% e vleres se kontrates per 60 ditë, kurse pjesa e kualitetit 10% e vleres do te kalkulohet me punët e projektit bazë.

VI

Bazë për nxjerrjen e kësaj Aneks Kontrate është kërkesa e të dyja palëve për punën shtesë e cila është e domosdoshme qe duhet te kryhet.

VII

Kjo kontrate hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit te saj

KONTRAKTUESIT
Hani i Elezit, 22.12.2022

shpk. “Murseli Company”
Rexhep Murseli



Komuna Hani i Elezit
Xhevdet Bushi
Shef i Z.Prokurimit
Mehmet Ballazhi
Kryetar i Komunës Hani i Elezit



Paramasa dhe Paralogaria e Punëve Shtesë
NDËRTIMI I PARKUT "ISA BERISHA" NË HAN TË ELEZIT

Nr.	Pershkrimi	Njësia	Sasia e punëve të kontraktuara	Sasia e punëve shtesë	Çmimi (€)	Shuma (€)
3	PUNËT E DHEUT, TERRENIT, MBUSHJES, SISTEMI UJITJES.					
3.1	Gërmimi i gjere i dheut të kategoris III me trashësi deri në t=30cm për pregatitjen e bazës së parkut, formimin e shtigjeve për ecje dhe ciklista, këndat e lojërave si dhe hapësirave tjera në projekt. Një pjesë e dheut deponohet në kantier për përdorim në rregullimin dhe nivelizimin e hapësirave të nevojshme, ndërsa pjesa e teperet dhe e podobishme largohet në depot legale, në vendin ku e cakton investitori, në largësi jo më shumë se 10km.	m³	4812	1150	2.00 €	2,300.00 €
3.2	Furnizimi, transporti, rrafshimi dhe nivelizimi i terrenit me dhe të përpunueshëm (humus) me trashësi deri në t=20cm varësisht nga nevoja në terren, i klasit I për mbjelljen e barit. Dheu duhet të jetë i përmirësueshëm që lavrohet me mjete adekuate, të jetë për bar natyral për parqe. Në këtë pozicion përfshihet edhe ngjeshja me mjete dore adekuate për parqe. Llogaria për meter kub.	m³	1420	1001	3.00 €	3,273.00 €
Totali:						5,573.00 €

Nr.	Pershkrimi	Njësia	Sasia e punëve të kontraktuara	Sasia e punëve shtesë	Çmimi (€)	Shuma (€)
4	PUNËT E BETONIT DHE ARMATURËS					
4.1	Furnizimi, dhe vuarja në veper e betonit të armuar C25/30 për punimin e mureve kufizuese/brotjeve, themeleve për pajisjet montuese të lodrave, rrethojave, shtyllave të ndriçimit si dhe pozicioneve tjera nga betoni i armuar të paraqitura në projekt. Në çmim të llogaritë: kallupimi, betoni, demontimi i kallupeve. Kualiteti i betonit C 25/30 (përfshirë aditivët kundër kriprave dhe abrazionit). Llogaria për meter kub.	m³	110	21	70.00 €	1,470.00 €
Totali:						1,470.00 €

Nr.	Pershkrimi	Njësia	Sasia e punëve të kontraktuara	Sasia e punëve shtesë	Çmimi (€)	Shuma (€)
5	PUNËT E TOTUAREVE / SHTIGJEVE / PARKINGU/ SHESHI					
<i>Pozicioni përfshin punët në të gjitha sipërfaqet e punuara me kubëza betoni të paraqitura në pjesët grafike.</i>						
5.3	Furnizim, transporti për punimin i tamponit me gurë të thyer të fraksionuar -zhavor C 31.5mm t=10cm dhe ngjeshja e tij, me makina përkatëse me ngjeshmëri Mt=700kp/cm².	m³	301.44	250	10.00 €	2,500.00 €
Totali:						2,500.00 €

Nr.	Pershkrimi	Njësia	Sasia e punëve të kontraktuara	Sasia e punëve shtesë	Çmimi (€)	Shuma (€)
13	PUNËT E NDRIÇIMIT					
13.2	Furnizimi dhe shtrirja e kabllos elektrike nentokore 4x16mm AL, në llogari hyn edhe gypi fleksibil 40mm dhe shiriti sinjalizues. Llogaria për meter gjatesi	m	840	97	3.00 €	291.00 €
13.3	Furnizimi dhe shtrirja e shiritit të tokezimit 20x3mm, në llogari hyn edhe pllakat kryqzore dhe elementet tjera për funksionalizim. Llogaria për meter gjatesi	m	800	97	1.70 €	164.90 €
Totali:						455.90 €

REKAPITULIMI			
3	PUNËT E DHEUT, TERRENIT, MBUSHJES, SISTEMI UJITJES.	Totali:	5,573.00 €
4	PUNËT E BETONIT DHE ARMATURËS	Totali:	1,470.00 €
5	PUNËT E TOTUAREVE / SHTIGJEVE / PARKINGU/ SHESHI	Totali:	2,500.00 €
13	PUNËT E NDRIÇIMIT	Totali:	455.90 €
GJITHSEJ:			9,998.90 €

VEREJTJE: Te gjitha taksat te kalkulohen ne cmime

